



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:253444  
Datë: 22.02.2024  
Numri i dokumentit: 05361338

AC. nr. 10318/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit Z. B. nga fshati P., Komuna e Shtimes, përfaqësuar sipas autorizimit nga Xh. A., Avokat nga Ferizaj, kundër të paditurve Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson B. M., jurist pranë të paditurës KGJK, me objekt të kontestit kompensim i kamatës dhe fitimit të humbur, duke vendosur sipas ankesave të paditësit dhe të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2352/2014 datë 22.09.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 16.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN të pathemeltë ankesat e paditësit Z. B. nga fshati P., Komuna e Shtimes dhe të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2352/2014 datë 22.09.2021, në pikën I, II dhe IV, VËRTETOHET.

Pika III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.2352/2014 datë 22.09.2021, mbetet e pa shqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2352/2014 datë 22.09.2021, ka vendosur: I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z. B. nga fshati P., Komuna e Shtimes, ashtu që DETYROHET i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit për mbajtjen e të hollave të sekuestruara në vlerë prej 16,755.00 Euro për

periudhën prej datës 01.06.2000 deri me datën 23.07.2014 t'ia kompensoj vlerat si në vijim: për periudhën prej datës 01.06.2000 e deri me datën 20.12.2012, në emër të kamatës ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, shumën prej 8,613.78 Euro, ndërsa në emër të kamatës prej 8% për periudhën prej datës 21.12.2012 e deri me 23.07.2014, shumën prej 2,129.95 Euro, të gjitha së bashku në vlerë të përgjithshme prej 10,743.73 Euro (me fjalë: dhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e tre Euro e shtatëdhjetë e tre cent), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën detyrimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Z. B. nga fshati P., Komuna e Shtimes ndaj të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës që në emër të fitimit të humbur për periudhën deri me nxjerrjen e ekspertizës t'ia kompensoj vlerën prej 41,309.20 Euro (me fjalë: dyzet e një mijë e treqind e nëntë Euro e njëzet cent), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si e pabazuar.

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Z. B. nga fshati P., Komuna e Shtimes kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, si e pabazuar.

IV. DETYROHET e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë që paditësit në emër të shpenzimeve gjyqësore t'ia paguaj shumën prej 1,995.20 Euro (me fjalë: një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë Euro e njëzet cent), brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër pikës II. të këtij aktgjykimi, paditësi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e ankimuar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar në pikën II duke e aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditësit sa i përket kompensimit të fitimit të humbur, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu kundër pikës I dhe IV. të këtij aktgjykimi, e paditura Këshilli Gjyqësorë i Kosovës, me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e ankimuar për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe ta refuzoj në tërësi kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Ankesat e paditësit dhe të paditurës janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Z. B. nga fshati P., Komuna Shtime, me datë 28.08.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurve Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të kamatës dhe të fitimit të humbur, kërkesë kjo e precizuar me parashtrësën e datës 07.09.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, deklarimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.2352/2014 i datës 22.09.2021, me të cilin ka vendosur që të: Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se paditësit me rastin e kontrollimit në shtëpinë e tij nga Policia i ishin marrë 32.770.00 DM. Gjithashtu, nuk ishte kontestuese se i njëjti pas zhvillimit të procedurës penale ndaj tij ishte shpallur i pa-fajshëm, me aktgjykim të formës së prerë. Po ashtu, nuk ishte kontestues as fakti se të njëjtit (bazuar në kërkesën e tij) me datën 23.07.2014 Policia e Kosovës duke vepruar sipas urdhëresës së Gjykatës Themelore në Prishtinë i kishte kthyer shumën prej 16,755.00 Euro, që paraqiste kundërvlerën e të hollave që i ishin marrë, të konvertuara në valutën Euro. Së këndejmi lidhur me këtë fakt, ndonëse gjykata ka administruar prova, nuk do të lëshohet gjerësisht në vlerësimin tyre meqenëse të njëjtat janë të pa-kontestuar nga palët ndërgjyqëse. Sa i përket provës së administruar dhe emëruar si vërtetim për kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 01.06.2000, gjykata thekson se e njëjta është shënuar gabimisht (gabim teknik) në procesverbalin e seancës së datës 07.09.2021 sepse ky vërtetim do të duhej të emërohej vërtetimin për sendet e sekuestruara përkohësisht, i datës 01.06.2000 e jo vërtetim për kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht. Rrjedhimisht, edhe nga ky vërtetim gjykata ka konstatuar se paditësit i ishin sekuestruar - ndër të tjera – shuma e të hollave në vlerë prej 32,000.00 DM.

Më tej ka theksuar se: Sa i përket provës së administruar dhe atë barazim jashtë gjyqësor i datës 04.06.2014 vlen të theksohet se megjithëse asnjëra nga palët ndërgjyqëse, përkatësisht as pala paditëse e as e paditura e dytë nuk e kanë kontestuar faktin e ekzistimit të kësaj marrëveshje (barazimi jashtë-gjyqësor) megjithatë secila të njëjtën e kanë interpretuar në forma të ndryshme. Nga kjo provë, gjykata ka konstatuar se paditësi dhe e paditura e dytë kanë lidhur marrëveshje jashtë-gjyqësore në të cilën është theksuar se “pas shqyrtimit analitik dhe të gjithanshëm të kërkesës së të përmendur nga ana e komisionit për kompensimin e dëmit për shkak të dënimit pa arsye dhe privimit pa bazë nga liria, të dokumenteve si dhe shkresave të lëndës përkitazi me ekzistimin, llojin dhe lartësinë e dëmit, komisioni në fjalë i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në seancën jashtë kontestimore të mbajtur me datën 04.06.2014 njëzëri u dakordua që të jap: ofertën për ujdi – barazim jashtëgjyqësor në mënyrë që parashtruesit të kërkesës së lartpërmendur Z. B. ti ofrohet shuma prej 2,004.00 euro në emër të kompensimi të dëmit material (fitimit të humbur); shuma prej 2,004.00 në emër të kompensimit të dëmit jo-material (moral); t’i pranohet shuma prej 120.00 Euro në emër të përpilimit të kërkesës për kompensim dhe të

përfaqësimit nga ana e avokatit në përputhje me listën e tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës; t'i pranohet shuma prej gjithsej 550.00 euro, në emër të shpenzimeve të vizitave familjare dhe pakove. Shuma e gjithmbarshme sipas pozicioneve të mësipërme në emër të kompensimit të dëmit të pranuar nga komisioni është barazi me 4,678.00 Euro.” Në fund të marrëveshjes është theksuar se “së këndejmi, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij është pajtuar me lartësinë e shumës së ofruar dhe me nënshkrimin vetanak pakontestueshmërisht e pranon atë. Pranimi i kësaj oferte, e privon parashtruesin e kërkesës përkatësisht përfaqësuesin ligjor të kërkuesit nga e drejta e kompensimit të dëmit në procedurën përkatëse pranë gjykatës kompetente”. Rrjedhimisht, çështje e vetme kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësi ka të drejtë që të kërkojë kompensimin e lartpërmendur nga të paditurat, ashtu që e paditura e parë konsideron veten se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë përderisa e paditura e dytë konsideron se për çështjen për të cilën paditësi kërkon kompensim tanimë kanë lidhur marrëveshje jashtë-gjyqësore dhe i njëjti edhe është kompensuar nga e paditura e dytë. Rrjedhimisht, në lidhje me këtë çështje, palët kishin qëndrime tërësisht të kundërta.

Më tej ka theksuar se: Nga ekspertiza financiare e përgatitur nga A. K., e datës 26.12.2018, e plotësuar me datën 02.06.2021, gjykata ka konstatuar se nëse merret parasysh llogaritja e kamatës për depozitat mbi një vit pa destinim të caktuar, vlera e kamatës për periudhën prej datës 01.06.2000 deri me 20.12.2012 arrin shumën prej 8,613.78 Euro ndërsa vlera e kamatës për periudhën prej datës 21.12.2012 deri me 23.07.2014 arrin vlerën prej 2,129.95 Euro, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme prej 10,743.73 Euro. Për dallim nga kjo, nëse merret parasysh llogaritja e kamatës për depozitat familjare mbi 2 vite pa destinim të caktuar vlera e kamatës për periudhën prej datës 01.06.2000 deri me 20.12.2012 arrin vlerën prej 8,913.85 Euro ndërsa vlera e kamatës për periudhën pre datës 21.12.2012 deri me datën 23.07.2014 arrin vlerën prej 2,129.95 Euro, të gjitha së bashku në vlerë prej 11,043.80 Euro. Sa i përket fitimit të humbur, sipas ekspertizës vlera e pagave potenciale të parealizuarra për shkak të mjeteve të konfiskuara palës paditëse me supozimin se do të punonte në sektorin e ndërtimtarisë prej datës 01.06.2000 deri me datën 23.07.2014 është 41,309.20 Euro. Në lidhje me këtë, gjykata ia fali besimin e plotë kalkulimeve të bëra nga eksperti financiar në këtë ekspertizë financiare, pasi që e konsideroi si profesionale dhe të besueshme, për arsyet që do të paraqiten edhe në vijim të këtij arsyetimi të aktgjykimit.

Më tej ka theksuar se: Në lidhje me këtë, neni 154, i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 45/89 dhe 57/89, tash e tutje referuar si “Ligji i Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve” përcakton se “[kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.” Po ashtu, neni 136, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, tash e tutje referuar si “Ligji i Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve”, përcakton se “[kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.” Duke qenë se paditësi i është shkaktuar dëm me rastin e sekuestrimit të parave në shumën e lartpërmendur me datën 01.06.2000 dhe mbajtjen e tyre deri me datën 23.07.2014, ka lindur edhe detyrimi i të paditurës së dytë që të njëjtit t’ia kompensoj atë dëm. E gjithë kjo, në përputhje me dispozitat e lartpërmendura ligjore. Neni 185, i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve, shprehimisht

përcakton se “[p]ersoni përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. [...] Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.” Tutje, neni 186, i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se “[d]etyrimi i kompensimit të dëmit konsiderohet se rrjedhë për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”. Duke qenë se dëmi i shkaktuar ndaj paditësit bie në domenin e dy ligjeve, përkatësisht edhe të Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve e një periudhë kohore edhe brenda domenit të Ligjit të Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duhet theksuar se edhe sipas nenit 169, paragrafit 1, të Ligjit të Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se “[p]ersoni përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. [...] Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.”

Në lidhje me këtë, gjykata vije në përfundim se momenti prej kur ka filluar të rrjedhë detyrimi i të paditurës së dytë për kthim të mjeteve të paditësit tek vetë paditësi është data kur këto mjete edhe i janë konfiskuar padrejtësisht paditësit, përkatësisht data 01.06.2000. Rrjedhimisht, në këtë rast për periudhën prej datës 01.06.2000 deri me datën 20.12.2012 zbatohet dispozita e nenit 277 i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që përcakton se “debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjësë, edhe kamatën sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë.” Për dallim nga kjo, për periudhën prej datës 21.12.2012 deri me 23.07.2014 zbatohet dispozita e nenit 382 të Ligjit të Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që përcakton se “debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.” Paragrafi 2, i kësaj dispozite ligjore përcakton se “Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.” Ky interpretim është në përputhje me Mendimin Nr. 265/2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 02.12.2020, që përcakton se për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, ndërsa për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat caktohet në lartësi prej 8%.

Më tej ka theksuar se: Sa i përket pretendimit të të paditurës së dytë se paditësi dhe e paditura e dytë kanë lidhur marrëveshje jashtë-gjyqësore me nënshkrimin e të cilës paditësi ka humbur të drejtën e vet për të kërkuar kompensim tjetër në raport me të paditurën e dytë, sipas konstatimit të kësaj gjykate, ky pretendim nuk qëndron. Kjo pasi që ashtu siç qartë konstatohet nga barazimi jashtë-gjyqësor, përmbajtja e së cilës u paraqit në detaje tek elaborimi i provave në këtë arsyetim, palët janë pajtuar që paditësi me nënshkrimin e kësaj marrëveshje është privuar nga e drejta e kompensimit të dëmit në procedurën përkatëse pranë gjykatës kompetente. Megjithatë, privimi i kërkesës për kompensimin e dëmit në këtë marrëveshje është i kufizuar vetëm në kërkesën për kompensim dëmi sa i përket privimit të kundërligjshëm nga liria, ashtu siç është e evidentuar në këtë barazim jashtë-gjyqësor. Më konkretisht, në asnjë rresht të kësaj marrëveshje nuk është shënuar se kjo marrëveshje lidhet ndërmjet palëve nënshkruese edhe për paratë e sekustruara të paditësit. Përfundimisht, kjo gjykatë konstaton se paditësi me të drejtë ka kërkuar nga gjykata

që të njëjtit t'i njihet kamata për mjetet e sekuestruara e të mbajtura të sekuestruara për periudhën prej datës 01.06.2000 deri me datën 23.07.2014.

Më tej ka theksuar se: Kjo gjykatë, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit sa i përket kërkesës për kompensimin e fitimit të humbur në vlerë prej 41,309.20 Euro është e pabazuar. Kjo për shkak se paditësi nuk ka arritur me asnjë provë të vetme që të argumentonte pretendimin se i njëjti ka punuar si saldues apo se ka zhvilluar çfarëdo aktiviteti biznesor me të cilin ka gjeneruar të ardhura, e të cilat të ardhura do të mund t'i zhvilloheshin/shtoheshin në rast se i njëjti do t'i investonte paratë e sekuestruara. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se neni 7, i Ligjit për Procedurën Kontestimore shprehimisht përcakton se “palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.” Gjithashtu, neni 319, i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.” Duke qenë se pala paditëse ka dështuar që gjykatës t'i paraqes prova me të cilat do të argumentonte se i njëjti ka punuar/ushtuar veprimtari si saldues, e njëjta kërkesë edhe u refuzua si e pabazuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës është marrë në kuptim nenit 452 par. 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plot gjendja faktike dhe i njëjti nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e kërkesë padisë së paditësit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka aprovuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësit si të bazuar, pasi që edhe gjykatës së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar sepse në këtë rast, nuk ishte kontestuese fakti se paditësit me rastin e kontrollimit në shtëpinë e tij nga Policia i ishin marrë 32.770.00 DM. Gjithashtu, nuk ishte kontestuese se i njëjti pas zhvillimit të procedurës penale ndaj tij ishte shpallur i pa-fajshëm, me aktgjykim të formës së prerë. Po ashtu, nuk ishte kontestues as fakti se të njëjtit (bazuar në kërkesën e tij) me datën 23.07.2014 Policia e Kosovës duke vepruar sipas urdhëresës së Gjykatës Themelore në Prishtinë i kishte kthyer shumën prej 16,755.00 Euro, që paraqiste kundërvlerën e të hollave që i ishin marrë, të konvertuara në valutën Euro, fakte të cilat

ishin vërtetuar edhe nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë të cilët ishin të pa kontestuar për palët.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar edhe lartësinë e kërkesës, pasi që e njëjta një gjë të tillë e ka vërtetuar nga ekspertiza financiare e përgatitur nga A. K., e datës 26.12.2018, e plotësuar me datën 02.06.2021., i cili ka konstatuar se nëse merret parasysh llogaritja e kamatës për depozitat mbi një vit pa destinim të caktuar, vlera e kamatës për periudhën prej datës 01.06.2000 deri me 20.12.2012 arrin shumën prej 8,613.78 Euro ndërsa vlera e kamatës për periudhën prej datës 21.12.2012 deri me 23.07.2014 arrin vlerën prej 2,129.95 Euro, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme prej 10,743.73 Euro, e cila ekspertizë për gjykatën e Apelit është mjaftë e kurtë dhe e njëjta pasqyron gjendjen reale dhe të saktë dhe vërteton kërkesë padinë e paditësit sa i përket kamatës, gjë që edhe palët në procedurë nuk e kanë kundërshtuar ekspertizën në kuptim të llogaritjes së kamatës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se sipas nenit 154, i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, i vitit 1978, tash e tutje referuar si “Ligji i Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve” përcakton se “kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.” Po ashtu, neni 136, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, tash e tutje referuar si “Ligji i Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve”, përcakton se “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.” Duke qenë se paditësit i është shkaktuar dëm me rastin e sekuestrimit të parave në shumën e lartpërmendur me datën 01.06.2000 dhe mbajtjen e tyre deri me datën 23.07.2014 pa ndonjë bazë ligjore, e që sekuestrimi i këtyre mjeteve është bërë sipas aktvendimeve të gjykatës, e që në rastin konkret e paditura e dytë është në obligim të përgjigjet në raste të tillë, e njëjta duhet që të kompensojë atë dëm. E gjithë kjo, në përputhje me dispozitat e lartpërmendura ligjore.

Duke qenë se paditësit i është shkaktuar dëm nga sekuestrimi i mjeteve financiare në lartësinë e cekur më lartë, të njëjtit i është shkaktuar dëmi e që i cili dëmi duhet të kompensohet pasi që sipas nenit 185, i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve, shprehimisht përcakton se “personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. [...] Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.” Tutje, neni 186, i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se “detyrimi i kompensimit të dëmit konsiderohet se rrjedhë për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”. Duke qenë se dëmi i shkaktuar ndaj paditësit bie në domenin e dy ligjeve, përkatësisht edhe të Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve e një periudhë kohore edhe brenda domenit të Ligjit të Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duhet theksuar se edhe sipas nenit 169, paragrafi 1, të Ligjit të Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se “personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. [...] Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”. Në lidhje me këtë, gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka përcaktuar se momenti prej kur ka filluar të rrjedhë detyrimi i të paditurës së dytë për kthim të mjeteve të paditësit tek vetë paditësi është data kur

këto mjete edhe i janë konfiskuar padrejtësisht paditësit, përkatësisht data 01.06.2000. Rrjedhimisht, në këtë rast për periudhën prej datës 01.06.2000 deri me datën 20.12.2012 zbatohet dispozita e nenit 277 i Ligjit të Vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që përcakton se “[d]ebitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjës, edhe kamatën sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozimet e kursimit me të parë.” Për dallim nga kjo, për periudhën prej datës 21.12.2012 deri me 23.07.2014 zbatohet dispozita e nenit 382 të Ligjit të Ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet e paditësit në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale në lidhje me pjesën refuzuese të përcaktuar si në pikën II të aktgjykimit të ankimuar, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit në lidhje me fitimin e humbur në lartësi prej 41,309.20 euro, kjo për faktin se paditësi nuk kishte ofruar asnjë provë që mund të vërtetonin pretendimet e të njëjtit se në rast mos sekuestrimit të këtyre mjeteve, paditësi do të realizonte të ardhura nga investimi i tyre, kjo për faktin se paditësi nuk kishte ofruar prova se i njëjti kishte ndonjë profesion siç pretendon që ishte saldues, apo i njëjti kishte ndonjë biznes të tije nga i cili kishte realizuar të ardhura. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se neni 7, i Ligjit për Procedurën Kontestimore shprehimisht përcakton se “palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.” Gjithashtu, neni 319, i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.” Duke qenë se pala paditëse ka dështuar që gjykatës t’i paraqes prova me të cilat do të argumentonte se i njëjti ka punuar/ushtuar veprimtari si saldues, e njëjta kërkesë edhe u refuzua si e pabazuar në mungesë të bazës juridike dhe në këtë kuptim nuk është marrë për bazë ekspertiza financiare e cekur më lartë për këtë pjesë të kërkesës..

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të të paditurës së dytë, në lidhje me atë se e njëjta me paditësin kishin lidhur marrëveshje jashtë gjyqësore për kompensimin e dëmit material dhe jo material, por këto pretendime gjykata e Apelit nuk i morri për bazë, pasi që kjo marrëveshje është lidhur për kompensimin për forma të tjera të dëmit material dhe nuk është lidhur për kompensimin e kamatës për mjetet e sekuestruara e cila kërkesë është objekt shqyrtimi në këtë çështje kontestimore. Andaj, në këtë kuptim gjykata e Apelit nuk mund ta pranoj një marrëveshje të tillë ashtu siç pretendon e paditura, pasi që me të njëjtën është arritur pajtim mes palëve për kompensimin e dëmit material dhe jo material në lidhje me privimin nga liria dhe jo për kamatën e mjeteve të sekuestruara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPJ-së si dhe në përputhje.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.



Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi, duke mos e shqyrtuar pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, pasi që për këtë pikë nuk kishte pretendime ankimore.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.C.nr.10318/2021 datë 16.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v